



Date : 02.02.2021

Në pajtim me nenin 87, paragrafi 2, nën paragrafi 2.8 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) nxjerrë këtë : **PKJK - PPRC**

NJOFTIM

Nr. 06/2021
Dt. 02.02.2021

Kohëve të fundit është bërë fenomen përdorimi i procedurës së prokurimit për **shërbime të veçanta (Konsulentët /Kontraktorët individual)**, për një numër të madh të profileve të ndryshme për punësimin e punëtorëve.

Kjo është në kundërshtim me nenin 3 të Rregullave për Prokurim të Shërbimeve të veçanta i cili thotë:

Neni 3.1: Këto rregulla aplikohen vetëm për prokurimin e Shërbimeve të veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit sipas Ligjit për Zyrtarët Publik nr. 06-L-114. Shërbimet e veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit janë shërbime profesionale për të cilat Autoriteti Kontraktues ka nevojë por që nuk i plotëson kërkesat me stafin që e ka.

Neni 3.2: Konsulenti / Kontraktori individual është një **specialist në një fushë specifike**, i angazhuar nga Autoriteti Kontraktues në rolin e një këshilluesi.

Bazuar në këtë, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) kërkon nga të gjithë **Zyrtarët përgjegjës të Autoriteteve Kontraktuese të Kosovës** që procedura e prokurimit për shërbime të veçanta (Konsulentët /Kontraktorët individual), të përdoret në pajtim me nenet e lartë cekura dhe vetëm atëher kur nuk mund të zhvillohen përmes procedurave të rekrutimit sipas **Ligjit për Zyrtarët Publik** nr. 06-L-114.

Osman VISHAJ

Kryetar i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik

